

L I G J
Nr.8262, datë 15.12.1997

PËR VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANEVE E TË PIJEVE
ALKOOLIKE DHE PËR NGJYROSJEN E NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS

Në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike që prodhohen, importohen, magazinohen ose hidhen në qarkullim në Republikën e Shqipërisë, pajisen detyrimisht me pullën fiskale të Ministrisë së Financave.

Neni 2

Pulla fiskale e Ministrisë së Financave është letër me vlerë dhe monopol i shtetit.

Neni 3

Ngjyrosja e nënprodukteve të naftës, të parashikuara nga dispozitat në fuqi, që prodhohen në vend ose importohen dhe hidhen në qarkullim në Republikën e Shqipërisë, ka vlerën e pajisjes me pullë fiskale.

Ngjyrosja dhe denatyrimi i nënprodukteve të naftës në import bëhet nga organet doganore në momentin e hyrjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, kurse për ato që prodhohen në vend, ngjyrosja bëhet nga organet tatimore në momentin e magazinimit të tyre në depozitat e prodhuesit.

Ngjyrosja dhe denatyrimi do të bëhet me kimikate të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe në përputhje me standardet shtetërore.

Neni 4

Në rastet kur mallrat, të cilat detyrimisht duhet të jenë të pajisura me pullën fiskale të Ministrisë së Financave, ose rastet e nënprodukteve të naftës që duhet të jenë të ngjyrosura, kur organet shtetërore të autorizuara konstatojnë në import, magazinim apo kur ato janë hedhur në qarkullim se nuk janë të pajisura me pullën fiskale, bëjnë menjëherë konfiskimin e tyre.

Organi shtetëror i autorizuar për shitjen e tyre është i detyruar t'i pajisë ato me pullë fiskale, e cila lëshohet nga Ministria e Financave dhe është e ndryshme nga pullat e zakonshme që tregojnë detyrimet fiskale.

Neni 5

Në rastet kur kalimi i mallrave të sipërpërmendura në kundërshtim me këtë ligj përbëjnë veprën penale të kontrabandës, organet e policisë gjyqësore përkatëse njoftojnë menjëherë organin e ndjekjes penale të juridiksionit ku është konstatuar shkelja, i cili brenda 48 orëve merr masat për administrimin e rregullt ligjor të provave materiale.

Neni 6

Dekreti nr.1396, datë 7.3.1996 "Për vendosjen e pullave në artikujt e duhaneve dhe pijeve alkoolike", si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.1968, datë 18.12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**